

K Ë R K E S Ë

GJYKATËS SË RRETHIT TË FIERIT

Kërkuese: Entela Qazim Ali, lindur në Fier e banuese në Vadhize, e martuar, me një fëmijë.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të shtetasit Lirim Ali në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëshorti im, Lirim Ali ka shkuar në Greqi që para tre vjetësh si emigrant ekonomik. Që nga ajo kohë e deri më sot, jo vetëm nuk ka ardhur më në Shqipëri, por edhe nuk ka asnjë lloj komunikimi as me mua, as me ndonjë pjesëtar të familjes së tij. Për të vërtetuar kërkesën time, krahas provave shkresore në seancë gjyqësore, do të paraqesë dhe prova me dëshmitarë që hedhin dritë rreth këtij fakti.

KËRKUESJA
Entela Ali